

Gjakderdhjet e lehta që shfaqen pas disa orësh janë normale. Mund të kesh gjakderdhje të pakët ose njolla gjaku për disa javë. Cikli normal duhet të nisë brenda 4-8 javësh. Nuk duhet të bësh dushe vaginale, të përdorësh tamponë vaginalë dhe të kesh marrëdhënie seksuale deri kur të ndalojë gjakderdhja (dhe deri sa ti vetë ta dëshirosh).

Mjekja duhet të të japë informacion me gojë apo me shkrim për komplikacionet e mundshme, si t'i njohësh shenjat e tyre, dhe kur duhet t'i drejtohesh mjekes. Marrja e këtij informacioni është e drejta jote.

Duhet të të dërgojë në shtëpi një person i besuar, pasi aftësitë e tua reaguese mund të kufizohen nga anestezia dhe ilaçet kundër dhimbjes. Këshillohu me mjekun përpara se të ngasësh makinën.

KËRKO MBËSHTETJEN E DIKUJT TË CILËS I BESON GJATË KËTIJ PROCESI. MBËSHTETJA DHE NDIHMA E SIKUR VETËM NJË PERSONI MUND TË JETË SHUMË E DOBISHME.

PAÇ FAT!

Hulumtimi dhe përmbajta: PP, Kolektivi Feminist
Dizajni grafik: Kolektivi Zanat

Ky material është realizuar me mbështetjen e Heinrich Böll Stiftung, Zyra Tiranë. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e fondacionit.

Metodat e abortit kirurgjikal janë metoda përparë procedurës do të të bëhet anestezia intravenoze (injektohet në gjak). Në procedurat me vakuum, mjekja thith membranën mukozë të mitrës dhe embriionin me një tub të vogël. Në procedurat me kyretazh, mjekja, me anën e një instrumenti në formën e lugës (kyreta) gërvishet mukozën e mitrës, për të hequr embriionin ose fetusin. Njërimjet kësaj ndërpritet shtatëzënia.

Nëse qafa e mitrës është shumë e ngushtë, para kypetazhit zgjerohet butësisht me instrumenta. Në rastet të veganta, zgjerimi i qafës së mitrës mund të lehtësohet me medikamente (prostaglandina) që bëjnë zbutjen e saj.

Procedura zgjat 5 deri në 10 minuta dhe kushton 5 000 lekë të reja në institucione shtetërore. Pas abortit kirurgjikal, mund të dalësh nga institucioni shëndetësor menjëherë pas normalizimit të parameitrave jetësore.

ABORTI KIRURGJIKAL



Gjithashtu një vizitë kontrolli pas abortit medikal është e nevojshme për të konfirmuar ndërrerjen e shtatëzënisë, zakonisht në ditën e 4 dhe 2 javë pas procedurës.

Komplikacionet kryesore në abortet medikale përfshijnë: aborti jo i plotë, vazhdimi i shtatëzënisë, gjakderdhja dhe infeksioni.

Nëse ke këto simptoma, duhet patjetër t'i drejtohesh një institucioni shëndetësor: gjakderdhje e shumtë (mbushja e një apo dy tamponëve të mëdhenj apo pecetave sanitare (lines) të mëdha gjatë dy orëve të brenda 24 orësh pas Misoprostolit; temperatura e vazhdueshme (mbi 38°C), ose flitimi i sekrecione vaginale me erë të rëndë; dhimbje të fortë, të vazhdueshme apo me intensitet në rritje.

Është mirë t'i përdorësh këto tableta në praninë e dikujt që i beson. Nëse zgjedh ta bësh vetëm sigurohu që të kesh telefonin pranë vëllit ose një person tjetër për të kontaktuar mjekun. Mund t'i thash dikujt se nuk po ndihesh mirë dhe po pushon. Nëse më pas ke komplikacione, mund t'i thash se mendon se po përjeton një abort spontan.


BËJ TESTIN E SHTATËZËNISË

Nëse nuk të ka ardhur cikli në kohë dhe ke patur marrëdhënie seksuale pas ciklit të fundit, mund të jesh shtatëzënë. Të përzierat, dhimbja e gjinjve dhe lodhja janë simptoma të zakonshme në shtatëzëninë e hershme.

Megjithatë, mënyra më e lehtë për t'u siguruar menjëherë janë testet e shtatëzënisë, të cilin mund ta provosh që nga dita kur duhet të kishe patur ciklin e pritur e tutje. Përpara kësaj kohe, niveli i hormoneve të prodhuara nga shtatëzënia është shumë i ulët për t'u shfaqur në test dhe mund të marrësh një rezultat negativ të rremë.

Në Shqipëri, ndërprerja e vullnetshme e shtatëzënisë mund të kryhet **deri në javën e 12-të të shtatëzënisë**. Sa më herët të kryhet ndërprerja, aq më e lehtë është procedura, kosto dhe pasojat e saj.

Nëse dyshon se je shtatëzënë, merr një test shtatëzënie sa më shpejt!



Nëse bën abort me ilaçe, duhet të sigurohesh që ke atë një institucion mjekësor ku mund të marrësh trajtim urgjent në rast komplikacionesh, kryesisht gjakderdhjes së tepërt. Pyet mjekun për informacion rreth procedurës së kryer dhe shënojë dikun me qëllim që të mund t'ia tregosh një profesionistje dikun tjetër për të trajtuar komplikacionet e mundshme.

Sigurohu që të kesh peceta sanitare për përballimin e gjakderdhjes dhe ilaçe nga goja për qetësimin e dhimbjeve. Ibuprofen, Diclofenac dhe Naproxen janë me efektivë për kontraktim, por edhe Paracetamoli bën punë. Mos merr anti-spazmodikë si Buscopan sepse mund të ndikojnë në procesin e abortit.

Njollat e gjakut mund të vazhdojnë për deri në 30 ditë pas abortit medikal. Disa gra mund të kenë episode gjakderdhjeje masive 3-5 javë pas abortit.

Gjakderdhja dhe shtërngjimet e mitrës tregojnë se ilaçet po japin efekt. Në rastin e abortit me pilula, gjakderdhja mund të jetë më e madhe sesa gjatë ciklit, dhe mund të shqërrohet me mpksje. Efekte anësore të zakonshme përfshijnë të përziera, të vjella dhe diarre.



Mosha e shtatëzënisë llogaritet përafërsisht me sa javë kanë kaluar nga dita e parë e ciklit të fundit. Përcaktimi i saktë i moshës së shtatëzënisë bëhet nga vizita te mejkja.

VIZITO MJEKEN E FAMILJES OSE GJINEKOLOGEN

Mjekja zakonisht do të të rekomandojë një ekografi për t'u siguruar që je shtatëzënë. Ekografia përcakton edhe moshën e shtatëzënisë. Nga mosha e shtatëzënisë varet mënyra e ndërprerjes së shtatëzënisë.

Ka dy mënyra për ndërprerjen e shtatëzënisë:




Metoda e rekomanduar për abortin medikal është përdorimi i Mifeprestione, të pasuar nga Misoprostol (gjendet edhe nën emrin Gytoec). Mifeprestione bllokton progjesteronin, hormonin e nevojshëm për vazhdimësinë e shtatëzënisë. Misoprostoli provokon kontraktimet e mitrës dhe ndihmon të nxjerrë jashtë përmbajtjen e saj.

Për të marrë këto medikamente në farmaci, të duhet receta që jep mjekja gjinekologe. Nëse ke vështirësi t'i gjesh në farmaci, provo farmacitë që gjenden pranë materniteteve.

Mjekja që të dha recetën duhet të të shpjegojë se si duhen marrë tabletat. Mëqë me kujdes këto udhëzime. Mos merr vetëm tabletën e parë dhe jo të dytën më pas.

Aborti me tableta mund realizohet deri në javën e 12 të shtatëzënisë. Efektiviteti deri në javën e 6 është më i madh. Deri në këtë javë mund të bëhet aborti pa patur nevojë për pstrim me vegla më pas. Nëse kenë DIU (spiralen), duhet ta hiqni përpara abortit me tableta.

ABORTI MJEKËSOR ME TABLETA/PILULA



1 BËJ TESTIN E SHTATËZËNISË

2 VIZITO MJEKEN E FAMILJES OSE GJINEKOLOGEN

3 MJEKJA DO TË TË REKOMANDOJË MJË EKOGRAFI
(në bazë të moshës së shtatëzënisë)

ABORTI MJEKËSOR IME PILULA

ABORTI KIRURGJIKAL




Mund realizohet deri në javën e 12 të shtatëzënisë.



Më të përshatme në shtatëzënitë e avancuara, zakonisht mbi 6 javë.

Për të marrë pilulat në farmaci, të duhet receta që jep mjekja gjinekologe.

Metoda për abortin medical është përdorimi i Mifepristone, të pasuar nga Misoprostol



Procedura zgjat 5 deri në 10 minuta

Kushton 5 000 Lekë të reja në institucionet shtetërore

Midiqi me kujdes udhëzimet!
Mos marr vetëm tabletën e parë dhe jo të dytën më pas.

Mjekja duhet të të japë informacion për komplikacionet e mundshme

ABORTI MEDIKAL IME PILULA/TABLETA

ABORTI KIRURGJIKAL

Avantazhet	Disavantazhet	Avantazhet	Disavantazhet
Mënjaron kirurgjinë dhe anestezinë	Efektet e mundshme anësore që përfshijnë gjakderdhje vagjinale, dhimbje barku, të vjella, diarre.	Mund të kryhet në institucionet shëndetësore shtetërore	Duhet të kryhet në institucion të specializuar dhe nga personel i trajnuar
Ka gjakderdhje më 'natyrore', ngjashëm me ciklin menstrual	Pritje, pasiguri	Është metodë e shpejtë, që eviton kohën e pritjes dhe të pasigurisë.	Është metodë invazive, e cila kërkon në mënyrë të domosdoshme anestezi.
Emocionalisht më i lehtë për disa gra	Nevojiten vizita të tjera në klinikë	Gjakderdhja dhe dhimbja janë më të menaxhueshme se në abortin medical.	Kushton 5 000 ALL Lekë të reja në institucionet shtetërore.
Mund të kontrollohet nga vetë grua,ja, më shumë privatësi dhe autonomi	Kosto e pilulës	Nuk kërkon vizita të përsëritura në klinikë ose në spital.	Ka rrezik më të lartë për dëmtime të mitrës, cervikale, dhe për infeksione pas abortit.
Mund të kryhet në shtëpi	Zakonisht përdoret vetëm deri në javën e 6		

Nuk ka rrezik dëmtimesh cervikale dhe të mitrës

LIQJTI PËR ABORTIN NË SHQIPËRI: NJIHU ME TË DREJTAT E TUA

Në Republikën e Shqipërisë, ndërprerja e vulinetshme e shtatëzënisë mund të kryhet deri në javën e 12-të të shtatëzënisë.

Ky afat shtyhet në 22 javë nëse aborti vlerësohet si për arsye shëndetësore apo sociale nga një komision.

Ndërprerja e shtatëzënisë për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatëzënisë, nëse miratohet nga një komision prej 3 mjekësh, të cilët pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykojnë nëse vazhdimi i shtatëzënisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikojnë jetën ose shëndetin e gruas.

Ndërprerja e shtatëzënisë për arsye sociale mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatëzënisë, nëse miratohet nga një komision prej 3 specialistësh (mjekë, punonjës socialë, juristë), të cilët pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykojnë nëse shtatëzënia është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër

seksual, ose evidentojne arsye të tjera sociale për abortimin.

Ndërprerja e shtatëzënisë pa pëlqimin e gruas përbën veprë penale në Shqipëri dhe dënohet me gjobë ose deri në 5 vite burg. Një grua mund të bëjë ndërprerje të shtatëzënisë pa miratimin e partnerit/partneres së saj.

Sipas ligjit shqiptar, nëse je nën 16 vjeç dhe e pamartuar, për ndërprerjen e shtatëzënisë kërkohet miratimi i një prindi apo kujdestari ligjor.

KONTRACEPSIONI

Një femër mund të ovulojë brenda 14 ditësh pas një aborti dhe mund të mbetet shtatëzënë nëse kryen marrëdhënie seksuale pa përdorur një metodë moderne kontrceptive. Pas abortit, mund të keshillohesh me mjeken për metoda të përshatshme kontracepsioni për ty.

Numra që mund të të hyjnë në punë

Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbrorethësha Geraldinë"

+355422222609

+35542225516

Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Kogo Gliozheni"

+35542370032

+35542267797